

# BIMBA SHOES SHPK

Adresa: Lgj 8-Shkurti,Rr.Kastriot Muco,9300 Fier,Shqiperi Mobil:069 774 2635

## KONTRATE DHURIMI KUOTA KAPITALI

Në Fier, sot më datë 14.02.2022 ( Dymijë e njetzet e dy ), në zyrën e shoqërisë të ndodhur në Lgj 8-Shkurti,Rr.Kastriot Muco,9300 Fier,Shqiperi,u paraqiten palët :

**1.MATEO ÇEPELE**,i biri i Hair-it , lindur me 03.02.1982 ne Roskovec,Fier dhe banues ne Lgj Mbrostar Ferko, Fier, madhor me zotesi te plote per te vepruar , identifikuar nga Pasaporta me numer BC2424715/I20203085M , ketu ne cilesine e Ortakut te **Shoqërisë** « BIMBA SHOES » shpk regjistruar me date 11.01.2022,me zyre qendrore ne Fier, Lgj 8-Shkurti,Rr.Kastriot Muco, numer indentifikimi subjekti M22511402N me status Aktiv - **në këtë kontratë “Pala Dhuruese”**.

**2.GLADIOLA ÇOBO**, e bija e Islam-it , lindur me 08.10.1988 ne Fier dhe banues ne Lgj Mbrostar Ferko,Fier, madhor me zotesi te plote per te vepruar , identifikuar nga Pasaporta me numer BB6773164/I86008075T, **në këtë kontratë “ Pala pranuese e Dhurimit ”** .

### **MEQËNËSE:**

-Pala dhuruese Z.Mateo Çepele ,ortak i shoqërisë « **BIMBA SHOES** » shpk me status Aktiv person juridik shqiptar me seli ne Lgj 8-Shkurti,Rr.Kastriot Muco,Fier Shqiperi,numer indentifikimi subjekti M22511402n me kapital themeltar 10.000,00 leke eshte zoterues i 10% te vleres se kapitalit te Shoqërisë dhe nepermjete ketij akti i dhuron Zj.Gladiola Çobo 10% te vleres se kapitalit qe ka ne pronesi ne Shoqërine « BIMBA SHOES » shpk, Fier.

-Palet kontraktuese pranojne transferimin e titullit te pronësisë te 10 % te kapitali nepermjete Dhurimit nga pala dhuruese tek pala pranuese e dhurimit e kane miratuar me vendim të asamblese se ortakeve te shoqërisë .

### **ATEHERE**

meqënëse ekzistojne parashtrimet si më sipër, palët bien dakord dhe lidhin këtë kontratë dhurimi si më poshtë:

#### **Neni 1**

##### **Objekti i Kontratës**

- **Pala dhuruese z.Mateo Çepele me vullnet te lire e te plote i dhuron zj.Gladiola Çobo 10% të vlerës së kapitalit te zotëruar prej tij në shoqërinë «BIMBA SHOES » shpk, Fier .**

**Transferimi i pronësisë do të bëhet nga pala dhuruese tek pala pranuese e dhurimit duke kaluar respektivisht titullin e pronësisë të 10% te kapitalit te shoqërisë në favor të zj.Gladiola Çobo, e cila e pranon këtë dhurim dhe ajo bëhet zotëruese e 40% te kapitalit te shoqërisë.**

#### **Neni 2.**

2.1 Palët bien dakord se pronësia kalon menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2.2 Palët bien dakort se kuotat janë të lira nga çdo pretendim i të tretëve, nuk janë të rënduara me barrë apo të ketë proces gjyqësor në lidhje me pronësinë e tyre.

#### **Neni 3.**

Regjistrimi në QKB

3.1 Pala dhuruese autorizon ortakun Zj.Gladiola Çobo të depozitojë këtë kontratë në QKB, duke shlyer detyrimet e regjistrimit.

**Neni 4.**

Shpenzimet për përpilimin e dokumentacionit

4.1 Palët bien dakort se pala pranuese e dhurimit merr përsipër kryerjen e shpenzimeve të tjera në lidhje me këtë kontratë.

**Neni 5.**

Të ndryshme

5.1. Kjo kontratë lidhet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi, perkatesisht Ligji "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" Nr.9901 Dt 14.04.2008, Mosmarreshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirekuptim. Në rast të kundërt, kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier.

**Neni 6.**

Hyrja në Fuqi e Kontratës

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e saj.

**Neni 7.**

Pjesët Përbërëse të Kontratës

7.1 Do të bashkëngjiten kësaj kontrate: kopje dokument identifikimi të palëve, ekstrakte QKB, vendim nr.5 dt 09.12.2021 dhe çdo dokument tjetër janë pjesë përbërëse e kontratës.


**Neni 8.**

Nënshkrimi i Palëve

8.1 Palalet deklarojnë se e kanë lexuar dhe kuptuar çdo pikë të kësaj kontrate, dhe e nënshkruajnë atë pa rezerva dhe me vullnetin e tyre të lirë në 3 (tre) kopje të barazvlefshme, nga të cilat një kopje për zyrën e QKB, ndërsa kopjet e tjera për palët për të përdorur nga ata.

PALA DHURUESE

Z.Mateo Çepele

MATEO ÇEPELE  


PALA PRANUESE E DHURIMIT

Z.Gladiola Çobo

Gladiola Çobo  
